



## REKOMANDIME

PËR HAPAT E ARDHSHËM NË PROCESIN E ZBATIMIT SA MË TË MIRE TË  
BUXHETIMIT GJINORË NË KOMUNËN E VITISË

Raport nga projekti “Monitorimi dhe Mentorimi i  
zbatimit të drejt të buxhetimit gjinorë në Komunën e  
Vitisë”

Shtator 2021

Viti



Bazuar nga **Memorandumi i Bashkëpunimit** të nënshkruar ndërmjet Organizatës për Reforma Lokale – **EULOC** në Viti dhe **Komunës së Vitisë**, të datës **19.01.2021**, nr **02-035/02-27**, në kuadër të pikës **1. Format a Bashkëpunimit**, paragrafi **IX** i Marrëveshjes, ku theksohet se “Në fazën e fundit të zbatimit të projektit, Komuna do të pranoj në formë të shkruar rekomandimet e dalura nga trajnimet (punëtoritë), Monitorimet e mbajtura, si udhërrëfyes për zbatim, përmes EULOC dhe do të zotohet që ato rekomandime të gjejnë zbatueshmëri sa më të madhe në Komunë.

Më tej Organizata EULOC si zbatuese e projektit **“Monitorimi dhe Mentorimi i zbatimit të drejt të buxhetimit gjinorë në Komunën e Vitisë”**, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtarë (SIDA) dhe mbështetur nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK), paraqet disa rekomandime të cilat bazohen në rezultatet e procesit të monitorimit dhe mentorimit të drejtorive komunale.

Konkluzionet dhe rekomandimet e dala si rezultat i Monitorimeve, Trajnimeve, punëtoritë e mbajtura (tryezat) janë si vijojnë më poshtë. Këto rekomandime të shqyrtohen dhe analizohen nga Kryetari i Komunës, përmes zyrës për Barazi Gjinore (ZBGJ), tek këshilli i drejtoreshave dhe organet përgjegjëse për mundësi të zbatimit sa më të madhe të tyre.

#	Të gjeturat nga Monitorimet, dhe Punëtoritë:	Rekomandimet:
1.	<p><b>Drejtoria për buxhet dhe Financa</b> Nga 26 të punësuar, 23 janë burra (88.5%) dhe 3 janë gra (11.5%).</p> <p>1.1. 85% të bizneseve të regjistruara nga viti 2012-2019 janë në pronësi të burrave dhe 15% janë në pronësi të grave.</p> <p>1.2. Raporti analitik i buxhetimit gjinor për vitin 2019 dhe planifikimi për vitin 2020 u miratua nga drejtoria e financave në dhjetor 2019. Buxheti është futur në planifikim për vitin 2021.</p> <p>1.3. Sfidë, pjesëmarrja e ulët e grave në proceset vendimmarrëse dhe në diskutime për buxhet. (arsyetim: koha e pa përshtatshme – muaji gusht etj. ).</p>	<p>1. Të rritet numri i grave në sektorin e financave (Drejtori)</p> <p>1.1 - Si masë afirmative bazuar në ligjin për barazi gjinore, drejtoria për buxhet dhe financa në bashkëpunim me ZBGJ, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, të identifikojnë iniciativat nga gratë për të bërë biznes, të organizojnë trajnime për përgatitje të plan bizneseve dhe të ndihmojnë ato në procedura të aplikimeve për subvencionime, grante etj, si rezultat do të kemi më shumë gra të vetëpunësuar dhe rritje të numrit të hapjes së bizneseve të reja nga to.</p> <p>1.2. Drejtoria e Financave të bëjë cdo vit vlerësimin dhe analizën gjinore të buxhetit, duke kërkuar vazhdimisht që të rris planifikimin më të mirë përmes një procesi të vazhduar të monitorimit gjatë zbatimit.</p> <p>1.3. Rekomandohet që strategjia e dëgjimeve buxhetore dhe publike të ndërroj në kohë dhe formë. (psh. Dëgjimet të organizohen gjatë muajve maj-qershor apo fillim korrikut kjo për</p>

#	Të gjeturat nga Monitorimet, dhe Punëtoritë:	Rekomandimet:
	<p>1.4. Është konstatuar që viti 2020 ka pasur të hyra më pak nga tatimi në pronë si pasojë pandemisë dhe kjo e ka rënduar situatën ekonomike.</p> <p>1.5. Drejtoritë Komunale në raportimet e tyre financiare dhe gjatë planifikimit të buxhetit nuk marrin për bazë perspektiven gjinore në planifikim dhe raportim të shpenzimeve.</p>	<p>arsye e mundësisë më të madhe të pjesëmarrjes së grave). Diskutime publike duhet të ketë edhe në situatë pandemie, përmes platformave online. Të angazhohen shoqëria civile në procesin e diskutimeve publike, ku të cilët do të ndikojnë dhe ndihmojnë në rritjen e pjesëmarrjes më të madhe të grave në këtë proces.</p> <p>1.4. Kërkohet që borxhet e mbetura nga viti 2020 të bartura në vitin 2021 të mundësohen të paguhen pa kamatë si rezultat i vonesave dhe në më shumë rata.</p> <p>1.5 Drejtoria të luaj rol kyq, ku në bashkëpunim me drejtoritë ndërsektoriale të planifikoj dhe raportoj mbi bazën e analizës gjinore dhe për të përdorur analizën gjinore për të informuar objektivat dhe treguesit specifik për rritjen e barazisë gjinore në nivel komunal. Cdo drejtori të plotësoj shtojcën e BPGj së bashku me kërkesat buxhetore ashtu sic kërkohet nga Qarkoret e Buxhetit.</p>
2.	<p><b>2. Drejtoria e Bujqësisë</b> Drejtori e udhëhequr nga një grua, mirëpo është numri i ulët i grave në këtë drejtori. Drejtoria e Bujqësisë ka 3 sektorë dhe ka 14 të punësuar, nga ta 12 burra (86%) dhe 2 gra (14%).</p> <p>2.1 Bujqësia si sektor me rëndësi, në kuadër të së cilit, gratë përfitojnë përmes subvencionimeve. Nga 1031 përfitues në vitin 2020 prej tyre ishin 654 burra (65%) dhe 357 gra (35%) në bujqësi. Subvencionim të mjeteve prodhuese dhe mbjelljet të rendimenteve bujqësore përmes organizatave financiare si: qeveria, grantet etj. Grupi Lokal i Veprimt GLV - Vitia, është aktiv me projekte bujqësore dhe subvencionime të grave në fushën e agro ekonomisë.</p> <p>2.2. Në njoftime për aplikim në thirrjet për subvencione, inkurajohen gratë që të aplikojnë.</p>	<p>2. Të rritet numri grave në këtë drejtori në mënyrë që të mundësoj përfaqësim më të barabartë.</p> <p>2.1. Të rritet më shumë subvencionimi i grave në projekte të prodhimeve nga kulturat bujqësore dhe artizanale. Nga 35% në vitin 2020 në 40% vitin 2021 dhe 45-50% deri në vitin 2023.</p> <p>2.2. Në njoftime për aplikim të inkurajohen më shumë gra që të aplikojnë dhe të kenë mbështetje gjatë procesit të aplikimit dhe përparësi më të theksuar gjatë procesit të përfitimit.</p>
3	<p><b>3. Drejtoria e Katastrit</b> Udhëhequr nga një grua,</p>	<p>3. Të rritet niveli i përfaqësimit të gruas në këtë</p>

#	Të gjeturat nga Monitorimet, dhe Punëtoritë:	Rekomandimet:
	<p>por stafi në shumicë dominohet nga burrat. Nga 9 të punësuar vetëm 1 është grua (11%) krahasuar me 8 burra (89%).</p> <p>3.1. Sfidë: fushata vetëdijësuese, e drejta pronësore e gruas. Mbi 95% e pronave janë të regjistruar në emër të burrave. Një pjesë bashkëpronar dhe numri i vogël pronare gra (të dhëna të bazuar edhe në hulumtimin e bërë nga EULOC – Raporti Qershor 2020 – facebook/EulocViti).</p>	<p>sektorë si staf përmes masave afirmative.</p> <p>3.1. Të organizohet fushata vetëdijësuese për të drejtën pronësore, regjistrimi i pronave nga dy bashkëshort apo nga gratë (në bashkëpunim me ZBGJ dhe organizata jo qeveritare).</p>
4.	<p><b>4. Drejtoria e Shëndetësisë</b> Përfaqësimi gjinorë në nivel më të lartë – krahasuar Qendrën për Punë Sociale (QPS) – 13 punëtor, 1 grua = 14 të punësuar në QPS – ku 1 grua është e punësuar në sektorin e asistencës sociale.</p> <p>4.1 Sfidë – trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga stafi i burrave. Në kuadër të komisionit për trajtimin e rasteve të dhunës nuk ka asnjë grua. Kjo situatë e bënë të vështirë procesin e trajtimit të drejt të tyre dhe zgjidhjen e problemeve. QPS nuk ka të punësuar një psikolog/e për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.</p> <p>4.2. Rritja e numrit të skemave sociale në 2020 mas pandemia. Këtu hyjnë përfituesit nga fondet qeveritare dhe aplikimet e reja nga skemat sociale.</p> <p>4.3. Rritja e numrit të rasteve të dhunës familje 2019-2020 - nga 25 në 2019 deri në 40 raste në vitin 2020. Gjithsej 65 raste të raportuara.</p> <p>4.4. Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Viti (QMF) – bëhet ofrimin i shërbimit të lehonisë-, ku pacientet munden të bëjnë vetëm kontrole gjinekologjike. QMF në Viti nuk ofron shërbime sa i përket lindjeve të foshnjave, kjo bëhet vetëm në Klinikën e Gjinekologjisë në spitalin Regjional në</p>	<p>4. Të rritet niveli i përfaqësimit të grave në kuadër të QPS.</p> <p>4.1. Të caktohet mundësia e financimit dhe rekrutimit të një psikologu/e në kuadër të QPS-së, për trajtim të rasteve të dhunës në familje, i/e cili/a do të ndihmonte në trajtimin më të mirë të këtyre rasteve.</p> <p>4.2. QPS bazuar në ligj dhe kompetenca të i trajtoj me kujdes aplikimet të skemave sociale, të cilat duhen verifikuar dhe trajtuar pa vonesa si pasojë esituatës si rezultat i pandemisë, ku përshkak humbjeve në vendin e punës, mbylljes dhe masave kufizuese, do të ketë shtim të familjeve që kërkojnë përfitim nga skemat sociale.</p> <p>4.3. Institucioni i Komunës në kuadër të QPS në bashkëpunim edhe me policinë e Kosovës të i trajtoj me kujdes dhe me kohë rastet e dhunës në familje, në mënyrë që të parandaloj rëndimin e situatave dhe të ndihmoj në zgjidhjen e problemeve bazuar në ligj dhe kompetenca.</p> <p>4.4. QKMF të rrisë kapacitetet në shërbimin mjekësorë të lehonisë, mundësia që të kryen raste të lindjeve në këtë qendër.</p>

#	Të gjeturat nga Monitorimet, dhe Punëtoritë:	Rekomandimet:
	Gjilan.	
5.	<p><b>5. Drejtoria e Arsimit</b> Sektorë me pasqyrim më të mirë sa i përket të punësuarve në sektorin e arsimit në lëmin e mësimdhënësve nga gjitha nivelet. Mirëpo sa i përket pozitave në vendimmarrje në drejtorinë e arsimit nga 7, 4 janë burra dhe 3 gra, ndërsa drejtor/e të shkollave, vetëm 2 gra janë në këto pozita dhe 1 grua drejtore e Çerdhes së qytetit (nga 21 drejtor, vetëm 3 janë gra = 7%).</p>	<p>5. Inkurajohen sa më shumë gra të marrin pjesë në pozita udhëheqëse në sektorë të DKA-së si dhe në pozita të drejtorëve të shkollave, edhe me masat afirmative në procesin e punësimit në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore.</p>
6.	<p><b>6. Kuvendi Komunal</b> Prej 27 anëtarë, vetëm 9 janë gra (33%) por që duhet 50% në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore. 6.1. Përfshirja më e madhe e burrave në diskutimet lidhur me investimet kapitale, shpenzimet. Tema me përmbajtje gjinore nuk janë iniciuar në këto seanca monitoruese.  6.2. Në Raportin e punës së Kryetarit të Komunës ë Vitisë, nuk është përdorur analizë gjinore nga sektorët e tjerë financiar në kuadër të raportimeve të shpenzimeve dhe punëve të administruara gjatë periudhës raportuese.  6.2.1 Në raportin e kryetarit të Komunës, në kuadër të pjesës së diskutimeve publike, raporti i pjesëmarrjes së gruas në këto diskutime është shumë i ulët; ku në të gjitha diskutimet 88% ishin burra dhe vetëm 12% gra pjesëmarrëse. Poashtu në diskutimin e strategjisë kundër dhunës në familje, ishin vetëm 10 pjesëmarrës nga ta 5 burra dhe 5 gra (mirëpo numër shumë i vogël në raport me rendësin e çështjes për diskutim) edhe pse ky takim ishte mbajtur me 20.02.2020 para situatës pandemike. 6.2.1 - Në diskutimet buxhetore numri grave pjesëmarrëse është shumë i vogël. (Mbase shumica e këtyre pjesëmarrësve shpesh herë janë zyrtarë komunal.) 6.3. Kuvendi Komunal ka formuar disa komitete konsultative, njëri ndër ta është</p>	<p>6. Partitë politike në Viti, të rrisin nivelin e pjesëmarrjes së grave në listat zgjedhore në mënyrë që të kemi përfaqësim gjinorë më të lartë në Kuvendin Komunal, bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore me 50% përfaqësim gra.  6.1. Anëtarët gra të kuvendit komunal të Vitisë duhet më shumë të përfshihen në diskutime dhe të adresojnë sfidat dhe të ndihmojnë avancimin e pozitës së gruas në shoqëri.  6.2. Të kërkohet nga anëtarët e Kuvendit Komunal që Raportimet ndërsektoriale të bëra deri më tani pa analizë gjinore të cilat janë të përfshirë në raportin e kryetarit, duhet të bëhen me analizë gjinore nga çdo raport ndërsektorial. (Psh: duke bërë analizë gjinore në raportim, mund të masim progresin e zhvillimit dhe nivelin e zhvillimit). Është edhe kërkesë lidhje me obligimet e caktuara në qarkun e buxhetit.  6.2.1 – Anëtarët e kuvendit komunal duhet të kërkojnë nga drejtorja për buxhet dhe financa që të hartoj një strategji apo plan veprimi konkret ku në kuadër të dëgjimeve buxhetore me qytetarë të përfshijë sa më shume gra nga zonat rurale dhe urbane (kjo mund të bëhet në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile dhe grupet tjera të interesit).  6.3. Të funksionalizohen Komitetet Komunale, me</p>

#	Të gjeturat nga Monitorimet, dhe Punëtoritë:	Rekomandimet:
	edhe Komiteti për Barazi Gjinore. Ky Komitet nuk ka qenë funksional përgjatë gjithë mandatit të formimit të saj nga anëtarët e kuvendit	theks të veçanet Komiteti për Barazi Gjinore në mënyrë që si trupe konsultative e kuvendit të ndihmoj në adresimin e shumë çështjeve sa i përket avancimit të rolit të gruas në shoqëri.
7.	<b>7. Komiteti për Komunitete</b> Në këtë komitete vetëm një grua është anëtare nga gjithësej 5 anëtarë (20%). Diskutimet në këtë komitete kanë për qëllim përmirësimin dhe adresimin e çështjeve me bazë nga komuniteti jo shumicë në komunën e Vitisë. Komuna e Vitisë në përbërje ka Shqiptar 99.59%, Serb, Kroat dhe Rom, Egjiptias 0.04% si grupe më të vogël bazuar në rexhistrimin e popullsisë të vitit 2011. Ndërsa në kuadër të zyrës për komunitete janë 3 zyrtarë nga ta 3 burra dhe asnjë grua (2 nga komuniteti Serb dhe një Shqiptarë)	7. Në kuadër të planit të punës të Komitetit në takimet duhet të përfshihet diskutimi mbi bazë gjinore, të adresohen çështjet gjinore në këtë komitet me bazë nga komunitetet pakicë, përfaqësimi i grave dhe vajzave nga komunitetet, përfaqësimin e vajzave në kuadër të zyrës për komunitete specifiku nga komuniteti rom dhe egjiptas.
8.	<b>8. Zyra për Barazi Gjinore</b> Komuna e Vitisë ka bërë përgatitjen e raportit analitik të buxhetimit gjinorë për vitin 2019 dhe planifikimi për vitin 2020, në kuadër të cilit raport ka nxjerrur edhe rekomandime, mirëpo si sfidë është parë procesi i monitorimit dhe mentorimit të zbatimit të rekomandimeve. Kjo përshkak që nuk ka një person përgjegjës apo zyrtarë të cilët do të monitoronin dhe mentoronin procesin e zbatimit të rekomandimeve të planifikimit, analizimit dhe raportimit të drejtë, duke përfshirë perspektiven gjinore në proces të punës.  8.1. Është parë si sfidë poashtu numri i vogël i stafit në (ZBGj) 1 zyrtarë për Barazi Gjinorë.	8. Të caktohet një zyrtarë/e për buxhetim gjinorë, apo caktimi i nga një zyrtari/e ndërsektorial të përfshirë në procesin e monitorimit dhe mentorimit, i/e cila do të bashkëpunoj me ZBGJ dhe do të ndihmoj procesin e monitorimit dhe mentorimit të buxhetimit të drejt gjinorë nga gjithë sektorët financiarë. Këto përgjegjësi duhet të përfshihen në kontratë të punës apo përshkrim të detyrave të punës.  8.1. Kërkohet që në kuadër të zyrës për Barazi Gjinore, të angazhohen staf ndihmës, të cilët do të ndihmojnë në procesin e zbatimit më të madh të politikave gjinore në Komunë, përmes monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të brendshme apo të jashtme në fushën e përmirësimit të barazisë gjinore.
	8.2. Pjesëmarrja, sidomos e grave por edhe të vajzave dhe të rinjve, në konsultime publike për planifikimin e buxhetit në nivel komunal, ishte shumë i ulët, sidomos nëpër fshatra, Pjesëmarrja e grave në fshatra në konsultimet e organizuara në vitin 2019 nuk ishte reprezentative.	8.2. Rekomandohet që ZBGj të organizoj një apo disa aktivitete vetëdijësuese nga qeveria komunale bashkë me shoqërinë civile, për pjesëmarrjen sa më të madhe të grave në proceset vendimmarrëse dhe debate publike (dëgjime buxhetore) kjo fushatë të planifikohet dhe të mbahet në shumicën e fshatrave në Komunën e Vitisë.

#	Të gjeturat nga Monitorimet, dhe Punëtoritë:	Rekomandimet:
9.	9. Grupet e grave dhe të rinjve nga shoqëria civile kanë identifikuar nivelin e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe institucioneve komunale si një çështje që do të duhej rishikuar.	9. Rekomandohet që më shumë gra dhe të rinj të jenë të përfshirë në komitete të ndryshme komunale në mënyrë që zëri i tyre të mund të dëgjohej më shumë.
10	10. Në një pjesë të fshatrave të Komunës së Vitisë mungon transporti publik (privat); shumë banor dhe sidomos gratë dhe vajzat kanë qasje të kufizuara (mungesë të veturave) në jetën shoqërore, në vetëpunësim, arsim dhe pjesëmarrje aktive në të gjitha proceset.	10. Komuna duhet të siguroj dhe organizon transportin publik-privat nëpër disa fshatra të thella të Komunës së Vitisë. Vlen të theksohet se gjatë zhvillimit të procesit mësimorë kemi shtrirje të rrjetit të transportit për nxënësit, mirëpo nuk ka transport të rregullt për udhëtarët e tjerë. Kjo ndihmon dhe mundëson qasjen më të lehtë në punë, në shërbime, në shkollë, etj., të të gjitha kategorive të shoqërisë, sidomos gratë, vajzat, nxënësit, etj.
11	11. Në Komunën e Vitisë ekziston vetëm një çerdhe publike (1 private) e cila ka kapacitete të kufizuara krahas nevojave të qytetarëve. Shumë gra nuk mundën të punojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri përshkak obligimeve dhe kujdesit ndaj fëmijëve në shtëpi.	11. Rregullimi i disa çerdheve në disa lokalitete të Komunës së Vitisë (fillimisht Pozheran, Viti). Kjo mundëson dhe ka ndikim në përmirësimin e kushteve dhe jetës të gjithë banorëve. Në veçanti mundëson që një numër i stafit të punësohet, poashtu rritja e kapaciteteve për përfshirje të sa më shumë fëmijëve në kujdes dhe edukim parashkollor. Gjithashtu ndikon që gratë të kenë mundësi dhe qasje në vetëpunësim, punësim, shërbime dhe pjesëmarrje më të lehtë në të gjitha proceset, pasi ato njëherit lirohen nga obligimi i kujdesit ditorë ndaj fëmijëve në shtëpi.
12	12. Gratë në përgjithësi shpeshherë nuk kanë mundësi dhe përkrahje në iniciativa të ndryshme që krijojnë vetëpunësim. Ngritja e kapaciteteve të grave dhe aftësimi profesional i tyre është evidentuar si kërkesë dhe nevojë e madhe e cila mundëson aftësimin e tyre dhe përgatitjen për tregun e punës dhe iniciativave për vetëpunësim përmes subvencionimit.	12. Përkrahja dhe subvencionim i organizatave jo qeveritare të cilat merren me aftësimin e grave për vetëpunësim përmes aftësimin profesional dhe subvencionimit në biznese.

## Mjetet e sugjeruara për buxhetimin gjinorë në nivel Komunal

Kjo tabelë tregon hapat e ciklit të planifikimit, veprimet përgjatë fazave të ciklit dhe përgjegjësit opsional të veprimeve.

Cikli i planifikimit	Veprimet përgjatë fazave të ciklit	Kush mund ta beje?
Mbledhja e të dhënave/ konsultimi me palët e interesuara	Buxheti me pjesëmarrje të ndjeshme gjinore	Një ekip, planifikues komunal dhe zyrtarët e financave, antarët e kuvendit që përfaqësojnë fshatrat në veçanti, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Shoqëria civile mund të ketë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit.
	Analiza gjinore në kontekstin komunal	Zyrtar për barazi gjinore që është përgjegjës për integrimin gjinor në komunë bashkë me drejtorët e sektorëve përkatës
Përpunimi i planit	Lista kontrolluese gjinore	Nga Zyrtarët për Barazi Gjinore, nga drejtorët dhe/ose nga kuvendi komunal
	Plani gjinor i veprimit	Nga Zyrtarët për Barazi Gjinore, nga drejtorët dhe nga kuvendi komunal
Buxheti	BPGj sipas qarkores buxhetore të Ministrisë	Nga drejtorët e drejtorive komunale
	Pasqyra e buxhetit gjinore	Nga drejtorët e drejtorive komunale
	Degjimet publike buxhetore	Nga departamenti i financave me mbështetje të shoqërisë civile; pastaj anëtarët e kuvendit mund të organizojnë debat për draft buxhetin nga perspektiva gjinore, bashkë me shoqërinë civile.
Implementimi dhe monitorimi	Dëgjimet publike buxhetore	Nga departamenti i financave me mbështetje të shoqërisë civile
	Treguesit kyç gjinore	Nëse komuna ka një njësi për planifikim dhe monitorim, atëherë treguesit e tillë duhet të jenë pjesë e sistemit, mundësisht si pjesë e bazës së të dhënave. Në Kosovë, komunat nuk kanë njësi të tilla, dhe as bazë të të dhënave. Në këtë rast, një bazë e të dhënave e thjeshtë mund të futet, duke përdorur një softuer të njohur për stafin.
	Monitorimi Shpenzimet	Kuvendi Komunal ka përgjegjësi të monitoron shpenzimet nëse janë flokuar të gratë dhe burrat në bazë të nevojave të identifikuar në baë të analizës gjinore.
Vlerësimi	Vlerësimi për përfituesin e ndjeshëm gjinore	Shefat e Departamenteve për shërbimet përkatëse, të tilla si arsimit, shëndetësia dhe sektori i gjuhësisë. Nga shoqëria civile si një pikë hyrjeje për të diskutuar dhe avokuar për shërbime më të mira.
	Lista kontrolluese	Nga zyrtarët për barazi gjinore, nga drejtorët dhe/ose nga kuvendi komunal.
	Vlerësimi Shpenzimet	Kuvendi Komunal ka përgjegjësi të vlerëson shpenzime dhe në ato janë avokuar të gratë dhe burrat në bazë të nevojave të identifikuar dhe në bazë të analizës gjinore. Në bazë të këtyre informatave do të merret edhe aprovimet e tyre lidhur me shpenzimet në të ardhmen.